**Sllavjanka Dimova** **Vera Angellovska**
**Marina Vasiq- Stefanovska**

# ARSIMI MUZIKOR

## Për klasën e V
## të arsimit fillor nëntëvjeçar

**Autorë:**
Sllavjanka Dimova
Vera Angellovska
Marina Vasiq-Stefanovska

**Redaktorë:**
Sllavjanka Dimova
Vera Angellovska
Marina Vasiq-Stefanovska

**Ilustrues:**
Sllavjanka Dimova
Vera Angellovska
Marina Vasiq-Stefanovska

**Recensente:**
dr. Ivica Zoriq
Frosina Cvetkova-Muratovska
Flurim Zulfija

**Lektor i botimit në maqedonisht:**
Tatjana Nankova

**Përkthyes:**
Antigona Fetahu

**Redaktim profesional:**
doc. Fatos Lumani

**Lektor i botimit në shqip:**
Abdulla Mehmeti

**Përgatitja kompjuterike:**
Vesna Gorjanska-Kërzheva
Dragan Arsovski

**Botues:** Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë
**Shtyp:** Qendra grafike shpkpv, Shkup
**Tirazhi:** 8.000

Me vendim të ministrit të Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Maqedonisë nr. 22-2411/1 datë 26.04.2010 lejohet përdorimi i këtij libri

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека “Св.Климент Охридски” , Скопје
373.3.016:78 (075.2) = 163.3
ДИМОВА, Славјанка
Музичко образование за V одделение : деветгодишно основно образование / Славјанка Димова, Вера Ангеловска, Марина Васиќ Стефановска. - Скопје : Министерство за образование и наука на Република Македонија, 2010. - 103 стр. : илустр. ; 28 см
ISBN 978-608-4575-94-8
1. Ангеловска, Вера [автор] 2. Васиќ Стефановска, Марина [автор]
COBISS.MK-ID 84083722

***I nderuar nxënës,***



Edhe këtë vit do të shoqërohesh me mysafirët e gëzuar nga shtëpia e muzikës. Ata do të ndihmojnë që t'i zbulosh sekretet e muzikës. Për t'i kuptuar, duhet që të provosh të këndosh, luash, krijosh dhe dëgjosh. Nëse i ndjek dhe i plotëson me kujdes aktivitetet dhe detyrat e dala nga libri, do të hysh në rrugën e muzikës. Nëse këndon, luan dhe gjurmon, bashkë me shokët e tu, do t'i zbulosh bukuritë e bashkëpunimit dhe arritjet e përbashkëta. Do të zbulosh se tingujt magjik do ta forcojnë shoqërinë, ndërsa zemrën do ta mbushin me gëzim dhe dashuri. Prandaj shpejto, kërce, këndo, luaj dhe dëgjoji përrallat e së kaluarës, të shprehura përmes tingujve. Zbuloji sekretet dhe fluturo nëpër botën e hareshme të notave!

*Autorët*



# *Bota ime*
## (me dëgjim)




| | |
|---|---|
| Сонце ме буди во постела,<br>песна ме гали во душата.<br>Три спомени што болеа<br>вечно ги избришав јас. | Dielli më zgjon në shtrat,<br>kënga më gjallëron në shpirt.<br>Tre kujtime që dhëmbin<br>përjetësisht i fshiva unë. |
| Мојот свет се вика музика,<br>нема вера ниту граница<br>мојот свет се осум ноти,<br>една душа балканска. | Bota ime quhet muzika,<br>nuk ka fe as ka kufij,<br>bota ime janë oktavat,<br>një shpirt ballkanik. |
| Најна најна, нанана најна...... | najna najna, njajna najna… |
| Мојот свет се вика музика,<br>нема вера ниту граница<br>мојот свет се осум ноти,<br>една душа балканска. | Bota ime quhet muzika,<br>nuk ka fe as ka kufij,<br>bota ime janë oktavat,<br>një shpirt ballkanik. |
| Мојот свет се осум ноти,<br>една душа балканска. | Bota ime janë tetë notat,<br>një shpirt ballkanik. |





***Aktivitet:***

1. Bëhu kreativ dhe krijo në temën ,,Bota ime muzikore”.





# *Këndoni fëmijë të botës*
## (me dëgjim)

Muzika: *Cyril Maqedonas*




Të vuajtur të mos ketë në botë,
dhe kurrë fëmijë të uritur,
e hareshme le të jetë dita,
për pleq dhe te rinj.

Тажни да нема на светот,
дечиња, никогаш глад,
радосен нека е денот,
за човек стар и млад.

Zemrat e fëmijëve janë burim,
lojë dhe buzëqeshje pa fund,
fat dhe lumturi në botë,
të lulëzojë në çdo skaj.

Refreni: La, la, la, la...

Срцата детски се извор,
игра и смеа без крај,
среќа и радост во светот,
да цути в секој крај.

Рефрен: Ла, ла, ла, ла ...



***Detyrë:***



1.Mbresat tuaja nga përmbajtja e këngës shprehi përmes vizatimit ose kartolinës, në temën ,,Për të gjithë fëmijët e botës”, me përdorimin e TIK-ut.



# Vlerat e notave

**Në këngët që i këndojmë dhe i luajmë,** melodia është e shkruar me nota të ndryshme, sipas lartësisë dhe kohëzgjatjes. Vlera e notës e përcakton kohëzgjatjen e tingullit. Deri tani i kemi përdorur **një të katërtën** dhe **gjysmë** notën.

***Të rikujtojmë:***

**Një e katërta e notës**



e pa - ra

**zgjat një rrahje**

**Gjysmë nota**



e pa - ra e dy - ta

**zgjat dy rrahje**

***Mbaje mend!***

1. **Një e katërta** e notës zgjat **një rrahje**. **Gjysmë nota** zgjat **dy rrahje**.



# Nota e plotë dhe pushimi

**Nota e plotë përbëhet nga koka e zbrazët e notës.**

**Nota e plotë zgjat katër rrahje.**




**Sinjali për heshtje që zgjat katër rrahje quhet pushim i plotë**





**Shënimi i pushimit të plotë në pentagram**



***Aktivitete:***

1. Në fletoren tënde shkruaj ushtrime ritmike dhe melodike me notë të plotë dhe pushim.
2. Bëhu kreativ dhe përpuno simbol për notë të plotë dhe pushim.







# Nota tetëshe dhe pushimi

***Të rikujtojmë:***




Vlera e notës së re që do ta zbulojmë quhet **notë tetëshe.**



**Nota tetëshe** është e përbërë nga:
koka e plotë e notës, vija e notës dhe flamuri i notës.




**Nota tetëshe zgjat gjysmë (1/2) rrahje.**




**Sinjali për heshtje që zgjat gjysmë rrahje quhet pushimi tetësh.**



**shënimi i pushimit tetësh në pentagram.**



***Aktivitete:***

1. Lexo dy, katër dhe tetë pushime tetëshe!
2. Sa rrahje zgjasin gjithsej?



# Aplikimi i notës tetëshe në këngë

## *Kubi magjik*




Mi-le ka kub ma-gjik, ai më tho-të nuk ësh-të sha-ka.
Shpir-ti i tij ësh-të ma-gjik, për çu-di na jep fu-qi.

Unë jam këngë e të tetës,
për ju të dashur fëmijë.
Jam magjik dhe jap fuqi,
prej jush asgjë nuk kërkoj.

Јас сум песна во осмини,
за вас деца мои мили.
Волшебна сум, сила давам,
од вас ништо јас не барам.





# Ushtrime ritmike dhe melodike me përdorimin e notës së plotë dhe pushimit

*Ushtrimi ritmik nr. 1*



*Ushtrimi melodik nr. 1*



*Ushtrimi rimik nr. 2*



*Ushtrimi melodik nr. 2*





# Ushtrime ritmike dhe melodike me përdorimin e notës tetëshe dhe pushimit

*Ushtrimi ritmik nr. 1*



*Ushtrimi ritmik nr. 2*

*Ushtrimi melodik nr. 1*



*Ushtrimi melodik nr. 2*



*Ushtrimi melodik nr. 3*





***Detyra:***

1. Emërtoje metrin e masës!
2. Përcaktoje sa rrahje ka masa kohore në ushtrimet melodike dhe ritmike.
3. Këndo dhe luaj me ritëm të saktë!





# Vendi i notave në pentagram

***Të rikujtojmë:***




Në shtëpinë e hareshme të muzikës të pranishme janë notat: **do, re, mi, fa, sol** dhe **la.** Secila prej tyre e ka vendin e saj në pentagram.

Bashkoju haresë së notave dhe këndoje këngën me tekst letrar dhe me solmizim.

## *Këngë gazmore*

Muzika dhe teksti: *S. Dimova*






***Mbaj mend:***

1. Notat shkruhen në sistem linear (pentagram), i cili përbëhet nga 5 vija dhe 4 zbrazëtira.

# Vendi i notave si 1 dhe do 2 në pentagram



Kënga e bukur dëgjohet larg. Në gëzimi do të bashkëngjiten edhe dy nota: nota **si1** dhe nota **do2**. Ato do ta marrin vendin e tyre në pentagram.






Nota **si1** shënohet në vijën  e tretë të pentagramit.
Nota **do2**  shënohet në zbrazëtirën e tretë të pentagramit.




Tani të gjithë notat janë këtu. Gëzimi le të vazhdojë. Të këndojmë këngë!

## *Këngë solmizuese*

Muzika dhe teksti: *S. Dimova*




Цртичка, главичка, полна
празна одлучи!
До, до, си, си, ла, ла, сол, ре,
фа, ми, ре, до, до, до.

Vizë , kokë, e plotë, e
zbrazët, vendos!
Do, do, si, si, la, la, sol, re,
fa, mi, re, do, do, do.



***Detyrë:***

1. Në fletoren tënde të muzikës shkruaji të gjitha notat e mësuara.





# Bllok flaute

*Të rikujtojmë:*




Kur t'i keni mbyllur shtatë vrimat dhe të tetën nga ana e poshtme e flautit, e keni fituar tingullin **do1.**

Kur do ta ngrini gishtin e vogël nga ana e djathtë, do ta fitoni tingullin **re.**
Kur do ta ngrini gishtin pasiv nga ana e djathtë, do ta fitoni tingullin **mi.**
Kur do ta ngrini gishtin e mesëm nga ana e djathtë, do ta fitoni tingullin **fa.**
Kur do ta ngrini gishtin tregues nga ana e djathtë, do ta fitoni tingullin **sol.**
Kur do ta ngrini gishtin pasiv nga ana e majtë, do ta fitoni tingullin **la.**

*Ejani të mësojmë se si krijohen tingujt* **si1** *dhe* **do2!**

Mbylli vrimat e flautit me gishtin e madh dhe gishtin tregues të dorës së majtë! E ke fituar tingullin **si1.**

Mbylli vrimat e flautit me gishtin e madh dhe gishtin e mesëm të dorës së majtë! E ke fituar tingullin **do2**.



# TABELA GRIF - Sistemi gjerman




E hapur ○ E mbyllur ●



# Ushtrime melodike me aplikimin e notave si1 dhe do2

*Ushtrimi melodik nr. 1*



*Ushtrimi melodik nr. 2*



*Ushtrimi melodik nr. 3*





***Aktivitete:***

1. Vëreji notat si1 dhe do2.
2. Interpretoji ushtrimet në mënyrë vokale dhe instrumentale!



# Aplikimi i notave si1 dhe do2 në këngë

## *Tanja këndon*

(me nota)

Teksti dhe muzika: *N. Mishçenko-Bodeb*




*Vërejtje:*

Është i lejueshëm ndryshimi i emrave në këngë, sipas nxënësve në klasë.





***Detyra:***

1. Emëroji vlerat e notave të përfshira në melodinë e këngës ,,Tanja këndon”.
2. Shkruaji me nota të plota notat e emëruara në tekstin letrar të këngës.







# *Mësuese, ti je bota ime*

(me dëgjim)

Muzika dhe teksti: *S. Dimova*






Për ty këndoj me zë,
të dua mësuese unë.
Me ty lulëzon Maji,
për fëmijët bota është parajsë.

*Refreni:*
Mësuese, ti je lulja ime,
për zemrën time je shërim.
dije se të dua pa fund,
përqafim të ngrohtë më jep ti.





За тебе пеам на глас,
те сакам учителке јас.
Со тебе цветен е мај,
за децата светот е рај.



*Рефрен:*
Учителке ти си мој цвет,
за моето срце си лек.
Те сакам бескрајно знај,
ти прегратка топла ми дај.



***Aktivitet:***

1. Bëhu kreativ dhe krijo një kartolinë urimi për mësuesen tënde.





# Masa kohore (takti)

Kompozimi muzikor është i përberë nga më shumë pjesë të vogla, të quajtura masa kohore. Në mes veti janë të ndara me vija vertikale, të quajtura **vijat e masave.**



**Masa kohore** (takti) është pjesë e vogël e kompozimit muzikor dhe paraqet distancë nga njëra në tjetrën vijë të masës.

Në fillimin e taktit shkruhet **metri i masës**. Ai e përcakton gjatësinë e kohëzgjatjes të masës dhe numrin e të rrahurave në masën kohore.

Të rrahurat masës janë: **të forta** (të theksuara) dhe **të dobëta** (të patheksuara).

I shënojmë me këto shenja:

| | |
|---|---|
| **—** | **Teza (kohë e masës e fortë ose e theksuar)** |
| **◡** | **Arëza (kohë e masës e dobët ose e patheksuar)** |

Numrin e kohëve të taktit, të forta dhe të dobëta e përcakton **metri i masës.**

**Shënohet në fillim të pentagramit, pas çelësit sol. Ai e përcakton ritmin e kompozimit.**

**2. Sa vlera notash ka masa?**
**4. Çfarë vlerash kanë notat?**







# Metri binar 2/4

***Aktivitet:***

1. Theksoje tekstin letrar me theks të saktë të fjalëve:

*Sot fëmijë këngë këndoj, të gjithë thonë që mundem.*
*Dua shoqëri, lojë të dashur, sepse ne na jep fuqi.*

Theksi i fjalëve në tekstin letrar bije në rrahjet e forta (të theksuara) të masës kohore. Për shkak të radhitjes në masa kohore të forta dhe të dobëta, ritmin e fjalëve do ta shkruajmë në **metër 2/4** .



| | | | |
|---|---|---|---|
| Де - нес | де - ца | пес - на | пе - ам, |
| си - те | ве - лат | де - ка | сме - ам. |
| Са - кам | друж - ба, | иг - ра | ми - ла, |
| заш - то | нам ни | да - ва | си - ла. |
| Sot | fë-mijë | kën-gë | kën-doj, |
| të gji-thë | tho-në | që | mun-dem. |
| Du-a | sho-që-ri | lo-jë | da-shu-ri, |
| sepse | ne na | jep | fu-qi. |

Masa me metër 2/4 lexohet me dy rrahje. Masa ka një rrahje të fortë dhe një të dobët. Pra, njësia e metrit të masës është nota katërshe.

**Nota katërshe zgjat një rrahje.**



**rrahja e parë** **rrahja e dytë**

Metri 2/4 është metër i rregullt binar. Shuma e notave në një masë me metër 2/4 duhet të jetë e barabartë me dy nota katërshe.

***Mbaj mend!***

1. Masa me metër 2/4 njësi metrike e ka notën katërshe.
2. Përmban dy masa kohore dhe lexohet në dy rrahje.

# Përdorimi i metrit 2/4 në ushtrime ritmike, ushtrime melodike dhe në këngë

*Ushtrimi ritmik nr. 1*



*Ushtrimi melodik nr. 1*



*Ushtrimi ritmik nr. 2*



*Ushtrimi melodik nr. 2*





# *E para, e dyta*

Teksti dhe muzika: *M.Vasiq-Stefanovska*



Пр -ва вто-ра, ле - ва дес-на, за- пеј се - га но - ва пес- на
E pa-ra e dy-ta, e maj-ta e djath-ta, kën-do ta-ni kën-gë të re,




О- дам нап-ред не - ма на-зад ти да чу- еш што ќе ка-жам, што ќе ка-жам.
Eci pa-ra nuk ka kthim ti të dë-gjosh çfa-rë të të them, çfa-rë të të them.

E para, e dyta, e majta, e djathta,
këndo tani këngë të re.
Eci para, nuk ka kthim,
Ti të dëgjosh çfarë të them?
Kohë të fortë, të dobët kam,
kështu botën mund ta kaloj.
Të gjithë fëmijët t'i shikoj,
ashtu i lumtur unë do të jem.



Прва, втора, лева, десна,
запеј сега нова песна.
Одам напред, нема назад,
ти да чуеш што ќе казам?
Силно, слабо време имам,
така можам свет да минам.
Сите деца да ги видам,
така среќен јас ќе бидам.



***Detyrë:***

1. Këndoje këngën me lexim (takt) të ulët.





## Luajmë në metër 2/4, metër binar

### *E para, e dyta*







# *Vjeshta*

Muzika: Stefan *M.Gajdov*
Teksti: *M. Ivanovski*

Mesatarisht e ngadalshme



Ле - то - то ни проj - де, жол-та е - сен доj - де,

Ve-ra ik-u, vjesh-ta e ver-dhë na er-dhi,



таж-ни лис-ja па - ѓаат, ки-лим ша-рен тка - ат.

Gje-the të zym-ta bi-en, qi-lim me shu-më ngjy-ra thurin.



е - сен е в се - ло град, гла - ва вед - не бо - рот сам.
ве - тер - чо под - дув - на гран - ка га - ли жа - ло - сна.

Vje-shtë në fshat e në qy-tet, për-kul ko-kën pi-sha ve-të,
e-ra fryn e de-gët ma-llën- gjy-esh-ëm i le-dha-ton.





***Aktivitet:***

1.Bëhu kreativ dhe jepi veshje të re drurit të zymtë të vjeshtës.
- Përgatit fletë nga letra në formë dhe ngjyrë sipas dëshirës. Në të shkruaj ose vizato një element nga njohuritë për muzikën. Të gjitha fletët e përpunuara nga letra ngjiti në hamer.



# Metri trinat 3/4



Lexoje tekstin në ushtrimin ritmik në formë ritmikisht të saktë dhe me theksim të drejtë të fjalëve.

## Një, dy, tre!




E pa-ra e dy-ta dhe e tre-ta jam unë,
ma-sa ko-ho-re për lo-jë jam shpë-tim.
Një, dy, tre, dy, dy, tre, këndo ti me zë!
Tak-te të re-ja më-soj në orë.

Teksti nga numërimi „**Një, dy, tre**” është i shkruar në metër trinat, i cili ka tri rrahje.

Nëse rrahjet e masës zgjasin nga një të rënë i shënojmë me metër ¾.

Metri 3/4 lexohet me tre të rëna. Ka një rrahje të fortë dhe dy të dobëta Njësia matëse e metrit 3/4 është nota katërshe.



**rrahja e parë** **rrahja e dytë** **rrahja e tretë**

**Metri ¾ është metër trinat.**
**Shuma e vlerës së notës është tre e katërta e notës, tre katërshe.**

***Mbaj mend:***

1. Metri ¾ për njësi ndërtimi ka notën katërshe.
   Përmban dhe lexohet në tre rrahje.

## Përdorimi i ¾ e taktit në ushtrime ritmike, ushtrime melodike dhe këngë

*Ushtrimi ritmik nr. 1*



*Ushtrimi melodik nr. 1*



*Ushtrimi ritmik nr. 2*



*Ushtrimi melodik nr. 2*



*Ushtrimi ritmik nr. 3*



*Ushtrimi melodik nr. 3*





# *Një, dy, tre!*

Бројалка




E para, e dyta dhe e treta jam unë,
masë takti për lojë jam shpëtim.
Një, dy, tre, dy, dy, tre, këndoni me zë!
Takte të reja mësoj në orë.
E para e dyta dhe e treta me radhë,
këndoni fëmijë të gjithë botës.

Прва и втора и трета сум јас,
тактова мера за игра сум спас.
Еден, два, три, два, два, три,
пејте на глас!
Ново тактирање учам на час.
Прва и втора и трета по ред,
запејте деца на целиот свет.





***Aktivitet:***

1. Këndoni këngën me shoqërimin e instrumenteve muzikore ritmike për fëmijë ose me lexim të ulët.







## Luajmë me metrin ¾

### *Valcer*











# Metri binar 4/4

Ushtrimi ritmik është i shkruar në metër 4/4 ose në metër binar dhe përmban katër rrahje.



Че - ти - ри по че - ти - ри, ај - де поч- ни иг - ра ти.
Цр - ве - ни и зе - ле - ни, жол-ти, пла - ви по - бе - ди.
Коц-ка ма -ла цр - ве - на, сед - на - ла на сре - ди - на.
Че - ка та - а трп - ли - во и - гра- та да за - поч - не.

Ka-tër nga ka-tër, e-ja fi-llo të lu-ash.
Të kuq dhe të gjel-bër, fi-to-re të kal-tër, të ver-dhë.
Ku-bi i vo-gël i kuq qën-dron në mes.
Pret me pa-du-rim lo-ja të fi-llo-jë.



**Metri binar 4/4** përmban katër rrahje:

— **e fortë** ◡ **e dobët** — **e fortë** ◡ **e dobët**

**Nota katërshe zgjat një rrahje**



rrahja e parë rrahja e dytë rrahja e tretë rrahja e katërt

**Metri 4/4** e taktit është metër binar me katër rrahje
Shuma e vlerave të notave duhet të arrijë katër nota katërshe.

***Mbaj mend!***

1. Takti katër pjesësh për bazë të masës së taktit ka çerek note. përmban katër kohë të taktit dhe lexohet në katër rrahje.

# Përdorimi i metrit 4/4 në ushtrime ritmike dhe melodike

*Ushtrimi ritmik nr. 1*



*Ushtrimi melodik nr. 2*



*Ushtrimi ritmik nr. 2*



*Ushtrimi melodik nr. 2*





# *Katër nga katër*

Muzika dhe teksti: *V. Angelovska*




**Të kuq e të gjel-bër, fi-to-re të ver-dhë, të kal-tër,**
**Pret a-jo a ja-në tre dhe lo-jën ta fi-llo-jë.**

**Црвени и зелени, жолти, сини победи.**
**Чека таа трпливо играта да започне.**






***Aktivitete:***

1. Përgatit ushtrim ritmik me katër masa.
2. Bëhu kreativ dhe me ndihmën e TIK përgatit vizatim ose aplikacion i cili do të ngjajë në (metrin) taktin 4/4.







# Katër nga katër

*Luajmë në instrumente për fëmijë*







# Krijimi dhe shprehje muzikore

Caktimi i llojeve të metrit nëpërmjet aktivitetit, krijimit dhe të shprehurit muzikor.

***Aktivitete:***

1.Arsimtari jep orientime dhe i njofton nxënësit me mënyrën e realizimit të aktivitetit të krijimit dhe shprehjeve muzikore me lojën e pllakave.

Demonstrimi i lojës: **model pllakash.**



Përcaktohen (formohen) nga tre deri në gjashtë grupe..

Udhëzim për realizimin e aktivitetit:

Secili grup duhet të përpunojë model të lojës me **pllaka**, në të cilën do të përfshihen të gjitha llojet e metrave: 2/4; 3/4; 4/4.

Secili grup e paraqet modelin e vet në **pllakë.**

Nga modelet e përpunuara grupore bëhet një model i madh pllakash, me mënyrë të lidhjes sipas dëshirës së nxënësve.

Kërce me rritëm, në koordinim me metrat në pllakën tuaj!

Nxënësi e ka për detyrë që t'i njeh fushat me metrin e dhënë, dhe të njëjtat t'i kërcejë sipas numrit të rrahjeve të masës.

Nxënësit të cilët e përmbushin detyrën, nga nxënësit tjerë marrin njoftim të përsëritur në formë gojore, se në mënyrë të saktë ose të pasaktë e kanë përmbushur detyrën.

# Shkalla tingullore (shkalla tonike)

Notat e shkruara në pentagram kanë emra dhe lartësi të ndryshme. Emrat e notave i përcakton shenja muzikore, çelësi sol, që shënohet në fillim të pentagramit. Kur notat i këndojmë dhe i luajmë i quajmë tinguj (ton). Secili tingull ka ngjyrë të caktuar, kohëzgjatje, forcë dhe lartësi. Lartësia e saktë e tingujve quhet **intonacion.**

Shkalla muzikore prej tetë tingujsh të ndryshëm, për nga emri dhe lartësia quhet **shkallë muzikore**. Ajo paraqet bazën e **alfabetit muzikor**.

Tingujt në shkallën muzikore tonike i emërojmë kështu:



**do1** **re** **mi** **fa** **sol** **la** **si** **do2**

***Aktivitet:***

1. Këndojeni shkallën nga poshtë dhe nga lartë me intonacion të saktë.




***Detyrë:***

1. Në tetë kartela të lidhura në varg prej peri, shkruaji emrat e tingujve nga shkalla muzikore (tonike). Të njëjtët mund të paraqiten me simbole sipas dëshirës.

***Aktivitet:***

1. Koordinator i aktivitetit është arsimtari.

- Tetë nxënës janë të radhitur në vijë të drejtë dhe përpara i mbajnë kartelat e punuara me emrat e tingujve. Secili nxënës duhet ta këndojë tingullin emrin e së cilit e mban.
- Duke filluar nga nxënësi që e mban emrin do1, secili nxënës e tregon emrin e tingullit tjetër të afërt.
- Secili nxënës duhet ta këndojë tingullin, emrin e të cilit e mban.
- Nga ky aktivitet kuptuam se në mes tingujve ka distancë melodike.

**Distanca në mes dy tingujve të përafërt quhet shkallë.**

Ekzistojnë dy lloje të shkallëve:

» **Gjysmë shkallë,** distancë që e shënojmë me shenjën ∧

» **Shkallë e plotë,** distancë që e shënojmë me shenjën ‿

Shkalla muzikore në të cilën ka gjysmë toni në mes tingujve që gjenden në gradën e III,IV dhe VII,VIII paraqet **familjen dur.**

Në shkallën muzikore çdo tingull e ka vendin e vet.

**Vendi i tingujve në shkallën muzikore quhet gradë**

Gradat shënohen me numra romak:




***Mbaj mend!***

1. **Shkalla tingullore** është nivel melodik nga tetë tinguj të ndryshëm për nga lartësia. **Tingulli** i **parë** dhe i **tetë** janë me të njëjtin emër.

# Shkalla C-dur

Nga secili tingull në shkallën muzikore mund të krijohet shkallë të re, e cila do ta fitojë emrin e tingullit fillestar. Ekzistojnë dy lloje të emërimit të tingujve:

| | | |
|---|---|---|
| **Solmizues** (aretik) | **dhe** | **Alfabetik** (latin) |

Tani do të krijojmë shkallë muzikore nga tingulli **do.**
Ngaqë emri i tij alfabetik është C, shkallën e tingullit do ta quajmë:

**Shkalla C-dur**



| do1 | re | mi | fa | sol | la | si | do2 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| C | | | | | | | |
| I | II | III | IV | V | VI | VII | VIII (I) |

Gjysmë tone në shkallën **C-dur** ka në mes tingujve:




Grada III IV VII VIII

**Tonet e plota** gjenden në mes tingujve:

**do - re , re - mi , fa - sol , sol - la , la – si .**
C
**I II, II III, IV V, V VI, VI VII.**

# Tetrakordi




Shkalla muzikore mund të ndahet në dy pjesë të barabarta, të cilat i quajmë **tetrakorde.**

**Tetrakord (nga fjalët greke tetra-katër dhe korda-tel) paraqet shkallë prej katër tingujve.**

**Tetrakordi i parë** **Tetrakordi i dytë**







***Detyra:***

1. Shkruaje shkallën C-dur dhe shënoji tetrakordet në nuanca të ndryshme.
2. Bëhu kreativ dhe me përdorimin e TIK punoje një ilustrim në shkallën C- dur dhe karakteristikat e saj: emra, hapa, gradë dhe tetrakorde.





# *Këngë alfabeti*

Muzika dhe teksti: *S. Dimova*




Në fillim jam unë grada, e dyta ec pas meje,
e treta, e pesta, e katërta, e gjashta, e shtata
të gjitha me radhë.

Këngë kënduam, emra mësuam,
të gjitha i rregulluam, shkallë kemi formuar.

Прво јас сум стапало, второ оди по мене,
трето, петто, четврто, шесто, седмо се по ред.

Песна си запеавме, име си научивме,
сите ги наредивме, скала си направивме.




***Mbaj mend!***

1. Emërimi në mënyrë alfabetike i tingullit **do** është **C**!





# Ritmi



Në të kaluarën, komunikimi mes njerëzve zhvillohej përmes shkrimit, me anë të letrave. Informatat arrinin **ngadalë.**



Sot, teknologjia bashkëkohore kompjuterike na mundëson komunikim të **shpejtë.**
Për punë ashtu siç duhet dhe në kohë, faktor i rëndësishëm është shpejtësia e arritjes së informacionit.

Për paraqitje të duhur në kompozimit muzikor është e nevojshme të përcaktohet shpejtësi adekuate. Për atë qëllim, në muzikë e përdorim termin **ritëm.**

Kompozitori, në pajtim me karakterin e kompozimit e përcakton llojin e ritmit. Shenja e ritmit shënohet në fillim të kompozimit mbi pentagram. Në muzikë ritmi mund të jetë:

**i ngadalshëm** **mesatar** **i shpejtë**











## Dimri

### (pjesa e II e serenadës për orkestër me harqe)

Në ciklin ,,Stinët e vitit” të Vivaldit, janë përshkruar katër stinët e vitit: pranvera, vera, vjeshta dhe dimri. Përmes përdorimit të mjeteve shprehëse muzikore dhe përdorimit të ritmit të përshtatshëm,Vivaldi krijoi imazhe autentike tingullore.

Kompozimi është i ngjyrosur me tinguj të instrumenteve harkore: violina, viola, violonçela dhe kontrabas.

Në pjesën e dytë ,,Dimri”, melodia me ritëm të ngadalësuar i kap karakteristikat e një peizazhi dimëror: kaltërsia e ditës, degë të rënduara nga bora, bardhësia e shtigjeve të borës, lumenj të ngrirë, shkrirja e akullit dhe rënia e pikave të rënda të ujit.



***Detyrë:***

1. Përcaktoje llojin e ritmit në kompozim.





# Metronomi

***A e din se?***



Metronomi është pajisje me të cilin përcaktojmë ritmin në performancë.

Johan Nepomuk Melill ( 1771-1883 ) me ndihmën e mekanikut

Ditrih Nikollaus Vinkll (1780-1826) e kanë bërë metronomin e parë.

Ludvig van Betoven është kompozitori i parë i njohur që e ka shfrytëzuar metronomin.

Metronomët modern janë elektronik me kristalet e kuarcit, të cilat e mbajnë precizitetin, e njëjtë me ato që përdoren në orë dore.

Ekzistojnë metronomë edhe më modern, të cilët mund të japin dy apo më shumë zëra të veçantë.








Unë tro-kas ti-ka ta-ka
jap ri-tëm ja kësh-tu.
E pa-ra e dy-ta e tre-ta, e ka-tër-ta,
kën-do dhe lu-aj ti pa mundim.



# *Ora*




Natën, ditë vetëm trokas, tika, taka, tak.
Sikur mbrëmë, edhe sot, ashtu nesër prapë.
Dhe ju them juve, vetëm atë e di.

Ноќе, дење сал си чукам, тика, така, так.
Како вчера, така денес, така утре пак.
И ви велам вам, само тоа знам.





***Aktivitet:***

1. Interpretojeni këngën me ritëm të saktë me shoqërimin e instrumentit ritmik për fëmijë që do t’i përdorni fjalët: ,,tika, taka, tak, taka nesër prapë, vetëm atë e di”.





# Ushtrime dhe këngë me përdorimin e ritmeve të ndryshëm

(luajmë dhe këndojmë)

Ngadalë

***Melodia***

*K.M.Veber*




Mesatar



*Ushtrimi melodik nr. 1*

i shpejtë



*Ushtrimi melodik nr. 2*

i shpejtë





## *Ferma e Mekdonaldit të vjetër*




## *Vëllai Martin*

i shpejtë




Vëllaçko Martin, vëllaçko Martin,
Apo fle? A po fle?
Ora bie, ora bie,
din, dan, don! Din, dan, don!

Братче Мартин, братче Мартин,
спиеше ли? Спиеш ли?
Часовникот чука, часовникот чука,
дин, дан, дон! Дин, дан, дон!





# Ngadalësimi dhe përshpejtimi

Kur këndojmë apo luajmë paraqitet nevoja për ngadalësim gradual, apo përshpejtim për performancën e melodisë-ritmit. Këto ndryshime i shënojmë me terme dhe shenja muzikore.



## *Këngë popullore Ruse*




## *Oj Suzanë!*








***Aktivitet:***

1. Nxënësit duhet të ndahen në tri grupe. Secili grup duhet të ketë simbol për llojin e ritmit. Gjatë interpretimit të tij e demonstron simbolin që ta paralajmërojë ritmin në të cilin do ta interpretojë melodinë. Dy grupet e mbetura duhet të interpretojnë lëvizje ritmike në ritëm të caktuar me shoqërimin e instrumenteve ritmike.
2. Nxënësit mund të interpretojnë melodi dhe me përdorimin e shenjave për ngadalësim dhe përshpejtim. Për këtë aktivitet duhet të ndahen në dy grupe.





# Valsi








# Karnavali i kafshëve
# Kamil Sen-Sans



**Kamil Sen-Sans** është kompozitor francez. Në veprën ,,**Karnavali i kafshëve**" me mjeshtri të madhe prej kompozitori, duke përdorur instrumente të ndryshme dhe mjete të tjera shprehëse, krijoi motive të ndryshme muzikore. Në to prezantohen kafshët në një solemnitet të posaçëm- ,,**Maskenball**". Në tollovinë e madhe, secila kafshë fshihet nën maskë.

Tanimë kemi njohuri për ,,**Marshi i luanëve**", ulërima e të cilëve është prezantuar me tingujt e pianos. Karnavali është nxitje edhe për kafshët tjera. Tingulli muzikor a do të krijojë pamje për njoftimin e dëgjuesit dhe a do t'i zbulojë kafshët tjera nën maska?

Këtë do ta kuptoni nëse me kujdes e dëgjoni muzikën.





# Kanguri
## Kamil Sen-Sans

Në karnavalin e kafshëve janë edhe kangurët. Maskat e karnavalit nuk mund ta fshehin naivitetin dhe kureshtjen e tyre. Duke kërcyer hareshëm, me frikë dhe pasiguri vështrojnë duke dashur të bëhen pjesë e argëtimit dhe ngjarjes rreth tyre.

Që të paraqesë përshkrim të besueshëm për veçoritë karakteristike të kangurëve, kompozitori përdor mjete shprehëse muzikore. Nëpërmjet ndryshimeve të shpejtësisë dhe forcës së tingullit e regjistron lëvizjen e tyre, me instrument tingujt e së cilit tani më i ke të njohur.





***Detyra:***

1. Sipas mënyrës së performimit, në cilin lloj të muzikës bie kompozicioni?
2. Emërtoje instrumentin me të cilin interpretohet kompozimi.
3. Dëgjoje me vëmendje muzikën dhe çoje dorën sa herë që e vëren se ndryshon ritmi (përshpejtohet ose ngadalësohet).
4. Gjatë dëgjimit të serishëm ndiqe dinamikën e performancës dhe emërtoji ndryshimet me shprehje të dinamikës përkatëse ose shenja.
5. Me cilat mjete shprehëse kompozitori e kap kërcimin dhe kureshtjen e kangurëve?
6. Mundohu të krijosh tregim me tinguj ,,Kangurët naivë” sipas muzikës së dëgjuar, ose të bësh ilustrim figurativ.





# *Viti i Ri*

(me dëgjim )

Muzika: *S.M.Gajdov*
Teksti: *V.Kunovski*

*shpejtë*




Viti i ri, viti i ri, këndojmë
me zë, jehon kënga më e dashur,
dhuratë për ne.
Ke fuqi bore, natën që shndrin,
Ti je zanë e mirë, e bukur dhe
e dashur.

Нова, нова година,
пееме на глас,
ечи песна најмила,
подарок за нас.

Имаш снежна сила,
ноќва што се свила,
ти си нова добра вила,
прекрасна и мила.





## *Aktivitet:*

1. Interpretojeni këngën me shoqërimin e DMI ritmike.
2. Ndahuni në tre grupe:
   Grupi I- e këndon këngën me tekst letrar;
   Grupi II-e shoqëron këngën me DMI ritmik, në kohën e parë të taktit;
   Grupi III-(2-4 nxënës) në taktin e katërt dhe të tetë, sipas ritmit të këngës e thonë tekstin **din don, din don.**



## *Detyrë:*

1. Sipas tekstit të këngës mundohu të bësh dramatizim ose të programit tënd për Vitin e Ri.





# *Dordoleci*

(me dëgjim)

Përpunimin i tekstit dhe muzikës: *E. Glishiq*



Јас сум ју - нак си - лен здрав, че - кам зи - ма не-мам страв.

Unë jam trim i fortë, i shëndoshë, e pres dimrin nuk kam frikë.



Ка - па - шал - че и - мам јас, топ - ло пал - то мој е спас.

Kapelë, shall kam unë, xhaketa e ngrohtë është shpëtimi im.

Eja, eja, dordalec i bardhë,
unë të pres me shumë mall.
Borë të imtë ti na dhuro,
Sajin unë e kam ta dish.

Fryn erë, bie borë,
ajo për mua është shërim.
Do të rrëshqas unë deri në muzg,
ngrohtë do të ndjehem përsëri.

Дојди, дојди Снешко бел,
јас те чекам сè сум зел.
Ситен снежец ти ни дај,
санка јас си имам знај.

Дува ветре паѓа снег,
тој за мене ќе е лек.
Ќе се санкам јас до мрак,
топло ќе ми биде пак.





# Bien zilet









# Johan Shtraus



*Johan Shrausi*
*(i biri)*

**Johan Shtrausi,** i riu (Johann Strauss 1825 1899) është kompozitori i njohur austriak, dirigjent dhe violinist. Djali i Johan Strausit (i vjetri ), që është afirmuar me valcerët e tij dhe është quajtur ,,mbret i valcerëve”.

Edhe pse arriti sukses të madh si muzikant nuk dëshironte që djali i tij të bëhej muzikant. Me dëshirën e babait Johani i ri u bë bankar.

Tingujt magjik dhe ritmi i valcerëve që i ka dëgjuar në fëmijërinë e tij, te Johani nxitën ndjenjën e dashurisë për muzikën. Me ndihmën e nënës së tij dhe pa dijeninë e të atit, Johani ndiqte orë nga violina dhe kompozimi. Formoi orkestrën e vet, me të cilën i performonte pjesët e veta, por dhe pjesët e babait të tij.

Më vonë u bë dirigjent i salloneve për ballo në oborrin mbretëror. Krijoi muzikë për vallëzim, siç janë valcerët, etj. Disa prej tyre dhe sot performohen. Njëra prej veprave të njohura të tij është kompozimi ,,Marshi i Radecit”.





# Marshi i Radecit
## Johan Shtraus
(i biri)

Pjesa e shkurtë hyrëse, në mënyrë pompoze e paralajmëron karakterin solemn të kompozimit. Më shumë madhështi i japin tingujt e instrumenteve frymore. Tingujt dhe ngjyra e tyre në mënyrë të pa imponuar vërehet përmes dinamikës graduale të nuancave nga **piano** deri në **forte**. Në vazhdim, melodinë kryesore e plotësojnë instrumentet harkore.

Në dinamikën forte , sërish performohet melodia e njohur (tema), duke filluar me nuansimin gradual nga **piano** deri në **forte.**

Ky kompozim gjendet në repertorin e Koncertit tradicional Vjenez të vitit të Ri, i cili mbahet çdo vit më 1 janar. Ndoshta e ke dëgjuar në televizion apo në koncert. Duke e dëgjuar do ta përjetosh karakterin e melodisë. Ajo do të zbulojë pse njerëzit edhe sot kënaqen me të.





***Detyra:***

1. Përcaktoje llojin e muzikës sipas mënyrës së performimit.
2. Cfarë karakteri ka kompozimi ,,Marshi Radecit”?
3. Çfarë karakteri ka kompozimi ,,Marshi Radecit”?
   a) i ngadalshëm   b) mesatar   c) i shpejtë
4. Emëroji llojet kryesore të dinamikës në kompozim.
5. Shoqëroje melodinë me rënie të duarve gjithnjë kur të ndeshesh me performimin e melodisë në **forte.**





# Fraza (dy taktesh)

***Të rikujtojmë:***

1. Kompozimet muzikore përbehen nga pjesë më të vogla ose më të mëdha.
2. Pjesa më e vogël e tërësisë muzikore është motivi.
3. Siç ndërtojmë nga fjalët tërësi gojore ose vepra letrare, ashtu edhe nga motivet ndërtojmë tërësi muzike dhe vepra muzikore.

**Motive me fjalë**




**Dimër dimër bora bije i ftohti ngrin të gjithë ikin.**

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Dimër | dimër | bora | bije | i ftohti | ngrin | të gjithë | ikin |

**Motive me notat dhe fjalë**




## *Dimri*




***Detyra:***

1. Lexoje me përkushtim tekstin e këngës „Dimri”.
2. Këndoje këngën „Dimri” me diksion të qartë dhe nuansim dinamik.

***Aktivitete:***

1. Përcaktoji vargjet-fraza në tekstit letrar të këngës.
2. Arsimtari t'i interpretojë frazat me tekst notash, ndërsa nxënësit t'i përsërisin me tekst letrar.
3. Përcaktoni tërësitë muzikore të përbëra nga dy motive.




**Tërësia muzikore e përbërë nga motivet, quhet frazë (dy taktesh).**

***Mbaje mend!***

1. Fraza është tërësi muzikore e përbërë nga motivet. Më shpesh zgjat dy takte.

# Përcaktimi i tërësive muzikore, motivit dhe frazës

Në skemat e dhëna me shembuj me tekst dhe muzikë, janë përcaktuar tërësitë muzikore, motivi dhe fraza.

**Motiv me fjalë** **Motiv me fjalë**




**Frazë me fjalë** **Frazë me fjalë**





**Frazë me nota** **Frazë me nota**







**Frazë me nota dhe fjalë** **frazë me nota dhe fjalë**

***Detyrë:***

1. Në pjesën e mbetur të këngës ,,Dordoleci” (f.49) bëre analizën dhe përcaktoji:
   - motivet me fjalë,
   - **motivet me nota,**
   - frazat me fjalë,
   - frazat me nota.





# *Ninulla*

*J. Filip*








***Detyra:***

1. Ndiqeni tekstin me nota të kompozimit „Ninulla” dhe me vëmendje ndiqeni muzikën.
2. Dëgjoni dhe vëreni frazat muzikore.
3. Sa fraza ka gjithsej kompozimi?
4. A ka përsëritje të frazave muzikore?
5. Mundohuni ta këndoni melodinë e këngës.





# Dinamika

***Të rikujtojmë:***

1. Në këngën ,,**Jehona**", me aplikimin e shenjave dinamike **f-forte** dhe **p-piano**, kompozitori ka bërë imitim të besueshëm të jehonës (eho). Në muzikë shenja **f-forte** do të thotë **fortë**, a shenja **p-piano** do të thotë këndim ose luajtje **e qetë**.

## *Jehona*

*Karl Marija Veber*




Во парк, во парк, во парк, во парк,
во убав цветен парк, хај, хај, хај, хај
Чуј ехов звук, чуј ехов звук,
во парк, во красен парк,
во парк, во красен парк.

Në park, në park, në park, në park
Në parkun e bukur me lulishte, haj, haj, haj, haj.
Dëgjo zë jehone, dëgjo zë jehone,
Në lulishte, në lulishten e bukur,
Në lulishte, në lulishten e bukur.

| **f** | **p** |
| --- | --- |
| **forte-e fortë** | **piano- e qetë** |

***Aktivitet:***

1. Këndojeni këngën me përdorimin e shenjave dinamike f, p dhe bëre imitimin e jehonës,

> ***Rekomandim:***
> Nxënësit mund të ndahen në dy grupe. Njëri grup do ta këndojë njësinë muzikore me shenjën f-forte, ndërsa grupi i dytë, njësinë e shënuar me shenjën p-piano. Me dëshirën e nxënësve mund të ndërrohen rolet.



# Nuancat dinamike

Ndonjë herë, kompozitorët idetë e tyre, ndjenjat dhe përjetimet i shprehin me ndryshimin gradual në fuqinë e zërit. Zëri mund të ulet ose të rritet. Fuqia e zërit mund ta arrijë lartësinë kulmore dhe përsëri të kthehet prapa.

Për këtë ndryshim, në literaturën muzikore përdoren shenja muzikore.

Zvogëlimi gradual i forcës së tingullit shënohet me shenjën **dekreshendo**.




Rritja graduale e forcës së tingullit shënohet me shenjën **kreshendo.**




Mesatar









## Mëngjesi nga suita „Per Gint”
## Edvard Grig

Edvard Grig ka qenë dashamir i natyrës. Është magjepsur në bukurinë e natyrës, që ajo i ofron njeriut. Bukurinë e mëngjesit me diell, kompozitori Edvard Grig e paraqiti në veprën e tij ,,Mëngjes”, nga suita e „Per Ging”. Lindjen e ditës së re, kompozitori e paraqiti me ritëm mesatar dhe ndryshim të fuqisë së tingullit.

Përmes melodisë, dëgjuesit ia përshkruan momentet e depërtimit të rrezeve të diellit të mëngjesit dhe qetësinë e mëngjesit. Edvard Greg paraqiti imazh të besueshëm muzikor të bukurisë dhe fillimit të ditës.





***Detyra:***

1. Emëroji ndryshimet graduale të fuqisë në performancën e kompozicionit.
2. Përmes shprehjes në formë letrare ose figurative, përshkruaje si e përjetoni mëngjesin e ri sipas muzikës së dëgjuar.



# Jehona
# Orlando di Laso

Orlando di Laso është kompozitor i lindur në Belgjikë. Jetoi në **shekullin XVI** të quajt**ur Renesan**ca. Ishte i arsimuar me muzikë dhe si fëmijë ka kënduar në korin e kishës Shën Nikollës në vendlindjen  tij, në Mons. Zërin e tij të bukur e vërejti për herë të parë zëvendësi i mbretit të Sicilisë dhe e dërgoi në Itali. Atje qëndroi një periudhë të gjatë, në më shumë qytete. Më vonë punoi në Holandë, Angli dhe në Gjermani, ku jetoi dhe krijoi deri në fund të jetës së tij.



*Orlando di Laso*

Ka shkruar më shumë së 200 pjesë në shumë zhanre dedikuar muzikës kishtare dhe shpirtërore. Shumica prej tyre u janë kushtuar zërave të njeriut dhe këndimit koral.

Pjesa „Jehona" është e dedikuar për kor. Në këtë kompozim, Orlando di Laso arriti ta përvetësojë jehonën e zërave. Këtë e arriti me imitimin e frazave dhe të ndryshimeve dinamike f-forte dhe p-piano.  Dëgjoje muzikën dhe mundohu t'i përjetosh ndryshimet dinamike.

***Detyra:***

1. Përcaktoje llojin e pjesës muzikore sipas mënyrës së realizimit.
2. Përmes cilit mjet shprehës na e ofron kompozitori **jehonën?**
3. Emëroji llojet e dinamikës në muzikën e dëgjuar.
4. Me cilën lloj të dinamikës kompozitori e paraqet **zërin** dhe me cilin **jehonën?**
5. Gjatë dëgjimit të ardhshëm paraqiti me simbole ndryshimet dinamike, p.sh:
   - me dorën e ngritur lartë dhe pëllëmbën e hapur –**f;**
   - me dorën gjysmë të ngritur dhe pëllëmbën e mbyllur –**p.**

# Shenja për vazhdimin e vlerës së notave

***Të përkujtojmë:***

1. Kohëzgjatja e notës mund të vazhdohet në shumë mënyra dhe me shenja të ndryshme.

Shenja 𝄐 **korona**
e vazhdon kohëzgjatjen e notës përafërsisht dyfish nga vlera e saj.





Korona më shpesh përdoren në fund të kompozimit muzikor, por mund të përdoret edhe gjatë kompozimit, në vende ku kompozitori dëshiron të rrumbullakojë një ide muzikore.

Shembull:



## *Ora*




***Detyrë:***

1. Këndoje këngën ,,Ora" me përdorimin e shenjës së koronës!

# Vazhdimi i vlerës së notave me hark dhe pikë

Shenja ⌣ **hark**

Lidh dy vlera të notave. Kohëzgjatja e të parës vazhdon me kohëzgjatjen e vlerës së notës së dytë.  Me këtë shenjë lidhen tingujt me të njëjtën lartësi, por me vlera të ndryshme të notave.



Shembull:



1 + 1 = 2    2 + 1 = 3    2 + ½ = 2½

Shenja ● **pikë**

E vazhdon vlerën e notave për gjysmën e kohëzgjatjes së tyre.



4 + 2 = 6    2 + 1 = 3    1 + ½ = 1 ½



***Detyrë:***

1. Krijo ushtrime me taktet 2/4, 3/4 dhe 4/4  me përdorimin e tingujve për vazhdimin **pikë** dhe **hark.**



# Përdorimi i shenjave për vazhdimin e vlerës së notave në këngë dhe ushtrime melodike

*Ushtrimi melodik nr. 1*



*Ushtrimi melodik nr. 2*

*G.F.Hendell*



## *Jehona nga bota tjetër*

(operë)

*Jakov Gotovec*



## *Çfarë çudie ndodhi*

*Këngë popullore*





# Këndojmë dhe luajmë

## *Vashat e vogla*

(me nota) *Këngë popullore*




Për secilën vashë nga një djalë,
Për Radën e bardhë arapi i zi,
Dhe habitet çka t'i bëjë.
Dy ditë e ka larë, tre ditë e ka shpërlarë.
Dhe e ka hipur në kalë të bardhë,
Kali zbardhohet, ai nxihet.





На сека мома по едно момче.
На бела Рада црно Арапче,
Па се чудила што да му прави.
Два дни го мила три дни го трила,
Па го качила на бела коња
Коњ се белее, он се црнее.



***Detyra:***

1. Në cilët takte ka vazhdim të vlerës së notës?
2. Cila shenjë për vazhdim është përdorur në vargun e parë, dhe cila në vargun e dytë të këngës?
3. Këndoje dhe luaje këngën me ritëm të saktë.







# Johanes Brams



*Johanes Brams*

**Johanes Brams** (1833-1897) është kompozitor i njohur gjerman. Jetonte në kohën kur kompozitorët me krijimtarinë e tyre i kanë shprehur ndjenjat e tyre momentale, shpeshherë të magjepsur nga bukuria natyrore, ndodhi dhe ngjarje interesante.

Johanes nuk rrjedh nga ndonjë familje e pasur. Qysh si i vogël kishte dëshirë të mësojë të luaj në piano. U shkollua vetë, ndërsa mjetet e jetesës i siguronte duke luajtur në piano deri natën vonë nëpër lokale.

Koncertin e tij të parë e mbajti kur ishte vetëm 15 vjeç. Më vonë jetoi dhe krijoi në Austri. Në krijimtarinë e tij dominojnë kompozimet për të rritur, por ai nuk i harroi as dëgjuesit dhe përformuesit më të rinj.



Me shokët e tij më të rinj-fëmijët, shpesh shoqërohej dhe i ka dashur pa kufij. Kjo i ndihmoi që ta njeh botën shpirtërore, nevojat, dëshirat dhe fantazinë e tyre.

Dëshira shumë e mirënjohur e fëmijës, me këngë që të flejë në përqafimin e nënës së tij, u shndërrua në inspirim për kompozimin ,,Ninulla”. Vlerat e tij artistike i përshtati për moshën e fëmijëve. Nëpërmjet melodisë së këndshme lehtë e ka përshkruar skofiaritetin dhe ngrohtësinë e mëmës kur e vë fëmijën në gjumë.

Tingujt e pianos dhe zëri, dinamika dhe tempi i matur në kompozim, e absorbojnë karakterin e qetë dhe me ëndje ninulle të muzikës.







# Ninulla

Kompozimi ,,Ninulla” është i shkruar për interpretim nga zëri femëror, nën shoqërimin e pianos. Melodia e saj entuziazmon me zërin e këndshëm. Është përkthyer në shumë gjuhë dhe përpunuar për kor të fëmijëve.

Lexoje tekstin e këngës. Ai do të ju ndihmojë në përjetimin dhe përcaktimin e karakterit të këngës.

*Johanes Brams*




Nesër kur në dritaren tënde,
dielli rrezet i lëshon,
këngë, hare në lojë me fëmijë,
i hareshëm, i lumtur do të jesh përsëri.

*Natën e mirë …*

Утре штом низ прозор твој,
сончев ѕирне зрак,
в игри, песни, детски пој,
добар весел ќе си пак.

*Добра ноќ ....*





***Detyra:***

1. Në cilin lloj të krijimit muzikor bie kompozimi:
   a) vokal b) instrumental c) vokal-instrumental?
2. Çfarë karakteri ka ky kompozim?
3. Përcaktoje llojin themelor të ritmit të performansës.
4. Emëroje dinamikën me të cilën performohet kjo këngë.
5. Sqaroje pse kompozitori ka përdorur ritëm të ndryshëm dhe ndryshime dinamike në këngë?
6. Përpiqu me ndihmën e arsimtarit dhe në bashkëpunim me shokët ta bësh dramatizimin e këngës, pastaj duke e shprehur saktë ritmin dhe dinamikën.





# Intervali

Në përmbajtjen e njësisë mësimore për shkallën e tingullit mësuat se distanca melodike në mes dy tingujve të afërta quhet **shkallë**. Ka shkallë **gjysmë toni** dhe **ton**.

***Aktivitet:***

1. Koordinatori i aktivitetit është arsimtari.
- Tetë nxënës janë të radhitur në vijë të drejtë dhe përpara i mbajnë kartelat e punuara me emrat e tingujve. Secili nxënës duhet ta këndojnë tingullin emrin e së cilit e mban.
- Duke filluar nga nxënësi që e mban emrin do, secili nxënës e tregon emrin e cilit do qoftë nga shkalla tingullore. Nxënësi që do të thirret duhet ta këndojë tingullin emrin e të cilit e mban, me ndihmën e nxënësve të klasës dhe të arsimtarit.

**Distanca në mes cilit do prej dy tingujve**
**në shkallën muzikore, ose në melodi, quhet interval.**
**Secili interval e ka emrin dhe madhësinë e vet.**

Tingujt në interval mund t’i këndojmë apo t’i luajmë veçmas (një nga një ), apo bashkë (të dy tingujt në të njëjtën kohë).





***Mbaj mend!***

1. Distanca në mes cilit do prej dy tingujve në shkallën muzikore ose në melodi quhet **interval..**

# Intervali prima (i parë)

***Aktivitet:***

1. Këndojeni shkallën e tingullit në kohëzgjatjen e notave sipas dëshirës tuaj, duke e përsëritur një tingull dy herë.



Vërejmë se në mes tingujve do-do, re-re, mi-mi, fa-fa, sol-sol, la-la, si-si, nuk ka distancë melodike, por vetëm përsëritje të tingullit.

**Distanca kohore melodike (intervali) në mes cilit do prej dy tingujve me emër dhe lartësi të njëjtë quhet prima.**

## *Unë jam prima*




***Detyrë:***

1. Në fletoren e muzikës me vlera të plota të notave shkruaj interval primar nga secili tingull në shkallën muzikore.

***Mbaj mend!***

1. Distanca melodike në mes cilitdo prej tingujve, me emër dhe lartësi të njëjtë, quhet **prima**

# Intervali i sekondës (i dytë)

Distancën në mes dy tingujve fqinj, në shkallën muzikore e quajtëm shkallë.

**Distanca melodike në mes dy tingujve fqinj**
**në shkallën muzikore (tonike) quhet sekondë.**

***Aktivitet:***

1. Këndojini sekondat në shkallën muzikore me kohëzgjatje të notave sipas zgjedhjes suaj.



## *Fqinjët*




***Detyrë:***

1. Në fletoren e muzikës, me vlera të plota të notave, shkruaj interval sekondar nga secili tingull në shkallën muzikore, lartë dhe poshtë.

***Mbaj mend!***

1. Distanca melodike në mes dy tingujve fqinj në shkallën muzikore quhet **sekondë**.



# Intervali i tetë (oktava)



***Aktivitet:***

1. Shkruaji notat do1 dhe do2.
2. Emëroji dhe këndoji notat të cilat gjenden në mes tyre.
3. A ekziston distancë melodike?
4. Zbulojeni se për sa tone janë të larguar tingujt njëri nga tjetri.





Ndërmjet tingujve do1 dhe do2 ka distancë melodike tetë tinguj. Kjo distancë melodike quhet **oktavë**. Për dallim nga intervali primar, në të cilin tingujt kanë të njëjtin emër dhe të njëjtën lartësi, te oktava tingujt janë me të njëjtin emër por me lartësi të ndryshme.

**Distanca melodike në mes dy tingujve me emër të njëjtë por me lartësi të ndryshme quhet oktavë.**

## *Emër të njëjtë kemi*






***Mbaj mend!***

1. Distanca melodike në mes dy tingujve me emër të njëjtë por me lartësi të ndryshme quhet **oktavë**.





# Aplikimi i intervalit të prima, sekondës dhe oktavës në ushtrime melodike

*Ushtrimi melodik nr. 1* *S. Gajdov*



*Ushtrimi melodik nr. 2*



*Ushtrimi melodik nr. 3*



*Ushtrimi melodik nr. 4*





***Detyra:***

1. Vëreji intervalet në ushtrimet melodike.
2. Luaji ushtrimet melodike.





# Folklori

***Të rikujtojmë:***

Të gjithë atë që e ka krijuar populli dhe që paraqet veçori të traditës së tij quhet krijimtari popullore. Përmes krijimtarisë së tij, populli e ka kultivuar dhe ruajtur kulturën dhe traditën e vet.

Termini **folklor** nënkupton krijimtarinë popullore (traditat, doket, zakonet, këngët, vallet, etj.). Prejardhjen e ka nga dy fjalë **folk** që do të thotë popull dhe **lor** krijimtari. Termi **folklor** përdoret si fjalë universale në të gjithë botën.

Kulturën popullore njeriu e ka krijuar që nga kohët më të hershme, me luftë për mbijetesë nëpër shekuj. Krijuesi, talentin e tij e ka shprehur përmes letërsisë, arkitekturës, këngës, valleve, veshmbathjes, instrumenteve popullore, qëndisjes, zanateve të ndryshme dhe shpërthimeve të tjera nga talenti dhe zemra e madhe e tij.





# Elementet e folklorit



*shtëpi e vjetër*

### E rënda dhe lehta



*gajde*

- Një njeri e pyeti një dijetar:
- Më trego o dijetar (filozof), çka është e rëndë dhe çka është e lehtë?
- Filozofi iu përgjigj:
- Të japësh këshilla është shumë e lehtë, por të veprosh sipas tyre është shumë e rëndë.

***Doket dhe zakonet***

Tradita popullore thotë se para ngjyrosjes të vezëve të pashkëve, amvisja duhet të hajë të paktën një kafshatë buke. Nëse nuk e bën këtë veza do ta humbasë domethënien dhe vlerën e saj.



*poçari*



*Manastiri Shën Joakim Osogovski*





*kostume*



*stoli*



*curle dhe lodër (daulle)*



***Aktivitet:***

1. Ndahuni në pesë grupe. Nga elementet e paraqitura të folklorit, secili grup le ta përbëjë një tërësi:
   Grupi i I - arkitekturë;
   Grupi i II - letërsi;
   Grupi i III - zanate (mjeshtri);
   Grupi i IV - krijimtari muzikore popullore;
   Grupi i V - artizanate (punëdore).



*qëndisje*



***Detyrë:***

1. Secili grup le të hulumtojë për elementin e vet të folklorit dhe në orën e ardhshme, me ndihmën e arsimtarit dhe me përdorimin e TIK-ut, të përgatitni broshurë.





# Folklori muzikor

***Të rikujtojnë:***

Këngët popullore, instrumentet dhe vallet paraqesin krijimtari popullore muzikore. Ato janë pjesë e folklorit dhe quhen **folklor muzikor**.

Termi **folklor muzikor** do të thotë krijimtari popullore muzikore. Këngët dhe vallet popullore nga populli shpesh quhen **muzikë popullore**. Kënga ka qenë pjesë e përditshmërisë së popullit. Krijuesi popullor ka kënduar, luajtur dhe vallëzuar. Në këtë mënyrë e ka shprehur vuajtjen, gëzimin, dashurinë dhe lirinë. Meqë melodia e këngëve dhe valleve popullore nuk ishte e shkruar, ajo është bartur gojë në gojë nga brezi në brez.
Në kohën më të re, me qëllim që të mbrohet origjinaliteti i këngëve dhe valleve popullore bëhet shënimi i tyre me nota.








# Elementet e muzikës folklorike



*gajde*

### Hajde në radhë radhiten familjet nga Koçani

(këngë popullore)

Hajde në radhë, radhiten moj,
Hajde në radhë, radhiten,
Familjet nga koçani.

Hajde unë do të shkoj, moj,
Hajde unë do të shkoj,
Përreth Kriva Rekës nënë moj,
Përreth Kriva Rekës.

Hajde do të më shkojnë, moj,
Hajde do të më  shkojnë,
Përreth Kriva Rekës nënë moj,
Përreth Kriva Rekës.

Hajde ta kërkojnë moj,
Hajde ta kërkojnë,
Ilo kaçakun nënë moj,
Ilo kaçakun.



*valle e përzier*

### Ајде ред се редат кочански сејмени

(народна песна)

Ајде, ред се редат, мале
ајде, ред се редат
кочански сејмени, мила мамо,
кочански сејмени.

Ајде, ќе ми одат мале,
ајде, ќе ми одат
покрај Крива Река, мила мамо,
покрај Крива Река.

Ајде, ќе го барат, мале,
ајде, ќе го барат,
Ињо арамија, мила мамо,
Ињо арамија.



*kavall*

### Rreth Vardarit rije

(këngë popullore)

Rreth Vardarit rije,
Kapelë të artë qëndisje
Sheqerlie, jabanxhie,
Dhe po plase do të marr.

Kapelë të artë qëndisje
Lot të dendur derdhje
Lot të dendur derdhje
Nënën fort e mallkoje.

### Крај Вардара седеше

(народна песна)

Крај Вардара седеше
алтан капче везеше
шеќерџиче, јабанџиче,
да пукнеш ќе те земам.

Алтан капче везеше,
дробни солзи ронеше,
дробни солзи ронеше,
луто мајка колнеше.



*valle grashë*



*daulle*



*curle*



*tupan (lodër)*





*valle burash*



*dajre (def)*

**Rum, Dum, dum**
(këngë popullore)

Curlet ushtrojnë në mes të
katundit,
Bie lodra, dum, dum, dum,
Djem të rinj, djem beqarë,
Nga dy valle luajnë.

Poshtë kalon një burrë plak,
Me mustak të përdredhur,
Drejtë në valle hyn,
Dhe ai të vallëzojë.

E vështroi gjyshja Nedë,
Për dore e kapi,
Ku po shkon plak budalla,
Vallen ta poshtërosh.



*kavall*



*tambures*



*qemane*
*(lahutë maqedonase)*



***Aktivitet:***

1. Emëroji elementet e folklorit muzikor.
2. Ndahuni në dy grupe. Nga elementet e dhëna të folklorit muzikor, secili grup le të bëjë një tërësi:
   Gupi i I - këngë popullore;
   Grupi i II - instrumente popullore;
   Grupi i III - valle popullore.



***Detyrë:***

1. Secili grup le të hulumtojë për elementin e tij nga folklori muzikor. Në orën e ardhshme, me ndihmën e arsimtarit dhe përdorimin e TIK-së, krijoni album.





# Këngët popullore

Kënga popullore është pjesë e folklorit muzikor. Ajo është e lidhur ngushtë me jetën e njerëzve, zakonet e tyre, festat dhe manifestimet. Përmes saj shprehen ndjenja dhe dëshira të ndryshme. Janë kënduar vuajtjet dhe mjerimi i popullit nëpër shekuj, dashuria ndaj atdheut dhe të afërmit, ndodhi të ndryshme kur njerëzit janë duke punuar, zakonet dhe traditat e tyre. Por shpeshherë e kanë shprehur edhe shakanë, humorin dhe satirën.





## Këngët popullore familjare

Në këngët familjare këndohet për jetën në familje dhe raportet në mes pjesëtarëve të familjes. Këtu bëjnë pjesë dhe këngët që këndohen në rrethin familjar.

### *Motra e thërret vëllain në darkë*

Këngë popullore




## Këngët popullore të dashurisë

Motivet në këngët e dashurisë janë të ndryshme. Më shpesh këndohet për dashurinë në mes vajzës dhe djalit, për takimin e tyre të parë, si dhe për pengesat me të cilat ndeshen në dashuri.

### *Prapa, prapa kthehu, moj vasha Kalinë*

Këngë popullore








# Këngët popullore gazmore

Këngët gazmore më shumë janë kënduar në ndeje. Në to, në mënyrë gazmore përshkruhet ndonjë ngjarje apo person.

## *Kam shtëpi në Pelister*

Këngë popullore




# Këngët popullore revolucionare

**Këngë kaçakësh** **këngë komitësh** **këngë partizane**

Përmbajtja e këngëve revolucionare është e lidhur me luftën e popullit për çlirim nga okupuesit. Shpeshherë janë përshkruar luftërat ose janë kënduar heronjtë e famshëm.

## *Dëgjoni atdhetarë*

Këngë popullore








## Këngët popullore të punës

**Këngë barinjsh** **këngë kurbeti** **këngë të korrje-shirjeve** **këngë argatësh**

Këngët e punës populli i ka kënduar gjatë kryerjes së punëve bujqësore dhe blegtorale, ose kur kanë shkuar në kurbet.

### *Mërgimi qoftë i shkretë*

Këngë popullore




## Këngët popullore të riteve

**Këngë kërshëndelash** **këngë vreshte** **këngë të pashkëve** **këngë Shëngjergji** **këngë razollesh.**

Këngët e riteve popullore i përshkruajnë festat dhe manifestimet e ndryshme tek bashkësitë e ndryshme kulturore.

### *Moj Lijarkë*

Këngë popullore








# Këngët popullore të traditës

**Këngë dasme** | **këngë dollish** | **kengë vajtimi**

Traditat e njerëzve nga vise të ndryshme janë kënduar në këngët e traditës.

## *Kalë dori shaloj unë*

Këngë popullore







Në mes të fshatit bie lodra, vallja hidhet.
Në mes të fshatit bie lodra, vallja hidhet.
Vallja hidhet, vajza e heq vallen
Vajza e heq vallen, vallen e zbukuron.

Babai e jep, në fshat nuk e jep.
Babai e jep, në fshat nuk e jep.
Në fshat nuk e jep se është e bukur,
Se është e bukur, e kuqe e bardhë.

Do të vdes nënë do të mbytem, pa të në shtëpi nuk do të vij.
Do të vdes nënë do të mbytem, pa të në shtëpi nuk do të vij.
Në fshat shërbëtor do të bëhem, vetëm atë ta marr,
në fshat shërbëtor do të bëhem, vetëm atë ta marr.

На сред село тапан чука, оро се вие.
На сред село тапан чука, оро се вие.
Оро се вие, мома водеше,
мома водеше, оро красеше.

Татко и ја дава, в село не ја дава.
Татко и ја дава, в село не ја дава.
В село не ја дава, оти е убава,
оти е убава, бела ем црвена.

Ќе умрам мајко загинам, без неа дома не одам.
Ќе умрам мајко загинам, без неа дома не одам.
В село слуга ќе бидам, само неа да земам,
в село слуга ќе бидам, само неа да земам.



***Aktivitet:***

1. Bëju kreativ dhe me ndihmën e arsimtarit bëre dramatizimin e një kënge ritesh.



***Detyra:***

1. Numëroji llojet e këngëve popullore sipas përmbajtjes.
2. Ndahuni në tetë grupe. Secili grup le të hulumtojë për një lloj kënge. Me ndihmën e arsimtarit dhe me përdorimin e TIK-së bëjeni një përmbledhje këngësh.





# *Unë të çova për ujë Kalinë*

(me dëgjim)




Unë të çova për ujë Kalinë.
Ti për ujë shkon, fytyrë e bardhë e lan,
pas beqarëve shikon moj Kalinë.

E mallkuar qoftë fytyra moj nënë,
Kur atë nuk ka atë kush ta dashurojë,
Ty nuk të dëgjoj moj nënë, hej.

Unë të çova në vreshta, moj Kalinë.
Ti në vreshta shkon, rrush të bardhë vjel,
beqarëve u jep, moj Kalinë.

E mallkuar qoftë vreshta moj nënë.
Kur nuk ka atë beqari ta hajë,
ty nuk të dëgjoj moj nënë, hej.





***Aktivitet:***

1. Formoni katër grupe nxënësish.
- Grupi i parë duhet t'i këndojë strofat e këngës, në të cilën nëna i drejtohet Kalinës.
- Grupi i dytë duhet t'i këndojë strofat e këngës, në të cilën drejtohet Kalina.
- Grupi i tretë është i shoqëruar me instrumente, ku përfshihen nxënësit, të cilët kanë afinitet për të luajtur në instrumente.
- Grupi i katërt ka detyrë të bëjë koreografi sipas përmbajtjes së këngës.









# Vallja e rëndë

(valle popullore)



***Të rikujtojmë:***

Në krijimtarinë popullore përfshihet gjithçka që një popull e ka krijuar ndër shekuj:

- fjalë të urta (gjëza, gojëdhëna, legjenda, përralla);
- artizanat (qilima,kostume, stoli);
- muzikë popullore (këngë, valle dhe instrumente popullore).

Nëpërmjet muzikës këngëtari popullor i ka shprehur ndjenjat e gëzimit, lumturisë, vuajtjet, dhembjet dhe dëshirat, por ka përshkruar dhe ngjarje historike dhe ndodhi të përditshme.

Koreografia e llojllojshme e valleve është shprehje e ndjenjave dhe ndodhive lidhur me përditshmërinë e jetës së njeriut.

## *Vallja e rëndë*

(himn i mundimeve të grumbulluara në shpirtin e popullit maqedonas)

Vallja e rëndë maqedonase konsiderohet si njëra nga vallet më të bukura dhe më të vështira të valleve popullore. Është e lidhur me kurbetin si fati i njerëzve në Maqedoni. Vallja buron nga momenti kur kurbetçinjtë nga Lazaropolja, Galiçniku, Gari dhe fshatra të tjerë mijakë, kanë shkuar në kurbet. Është luajtur në fund të fshatit, në vendin ku kurbetçarët ndaheshin me të afërmit e tyre, para se të shkojnë në punën e mundimshme në vend të huaj.

Në festën fetare Petrovden (e premtja e madhe) kurbetçinjtë kthehen në vendin e lindjes që të marrin pjesë në dasmat e të afërmve të tyre.

Të rënat e daulleve dhe zhurma e curleve e paraqesin fillimin e valles. Me lëvizje të ngadalshme valltarët formojnë rreth. Krye valltari jep shenjë me shami dhe valltarët kapen për dore. Qetë dhe në mënyrë dinjitoze fillon vallja me rrëfim për jetën e vështirë të popullit maqedonas.

Dinamikën e vallëzimit dhe ritmin e harmonizuar e çrregullon momenti kur kryevalltari hyp mbi daulle. Kjo simbolikë e paraqet thirrjen për fitore dhe rezistencë mbi vuajtjet, sakrificën dhe mundimet. Në vazhdim, vallja merr rritëm më të shpejtë. Secili valltar, për një moment është kryevalltar, e merr shaminë dhe udhëheq vallen, pastaj ia jep tjetrit në radhë. Mënyra e luajtjes (kërcimit) tingulli dhe ritmi që e krijojnë curlet dhe daullet, krijojnë atmosferë interesante. Me kalimin e kohës, vallja e rëndë u shndërrua në himn, jo vetëm për kurbetçinjtë, por edhe për të gjithë peshën e grumbulluar në shpirtin maqedonas, ndër shekuj të tërë robërie.





**Vallja** e rëndë dhe elementet e saj u bënë motiv i pashtershëm dhe inspirim. Janë shkruar shumë këngë dhe tregime letrare, janë xhiruar filma, janë përpunuar pjesë të muzikës klasike dhe këngë popullore dhe argëtuese.

Në përjetimin e karakterit të valles do të ndihmojnë dhe vargjet e shkrimtarit Bllazhe Koneski:

**„...Zinxhir i skllavit ti ishe,**
**derisa nuk u bëre popull në malin e bleruar,**
**deri sa me urrejtjen e mbledhur ndër shekuj,**
**nuk udhëhoqe valle të ngjeshur, valle kryengritëse!**
**U përkund vallja mes gjakut dhe zjarrit,**
**dhe zëri u dëgjua si bubullimë në tym**
**të shpërndau gjithkund këmba kryengritëse**
**në pragun e vendlindjes!...**



Vallja e rëndë
(valle popullore)



***Detyra:***

1. Emëroji instrumentet me të cilat përcillet vallja.
2. Me cilin ritëm fillon Vallja e rëndë?
3. A rritet apo ngadalësohet ritmi gjatë vallëzimit të mëtejshëm?
4. Emëroji shenjat dinamike të përmendura që i njeh, në performancën e valles: **p<, f >.**
5. Shpjegoje se çka shprehet me ndryshimin e ritmit dhe dinamikës së valles?
6. Mundohu që së bashku me arsimtarin dhe shokët, të vallëzosh me tingujt e valles.





# Oj Suzanë

Këngë amerikane






# Krijimi dhe shprehja muzikore

Krijimi dhe shprehja muzikore me temë për format muzikore..

***Aktivitet:***

1. Përcaktoje tërësitë e fjalëve-frazave në tekstin letrar të këngës:

   *Erdhi, erdhi pranvera, e bukur dhe e dashur.*
   *Zogjtë fluturuan, fole të reja ndërtuan.*

   Në këtë tekst ka dhe melodi.

## *Pranvera*




2. Mundohu që t'i radhisësh në mënyrë të drejtë njësitë muzikore-frazat, sipas tekstit letrar, dhe do ta fitoni melodinë e këngës.

3. Bëhu kreativ dhe shkruaje një tjetër tekst për këngën „Pranvera".

4. Ndahuni në tre-katër grupe dhe këndojeni këngën me shoqërimin e instrumenteve për fëmijë.





# *Dita e Pashkëve*
# *-*
# *ditë e madhe*

(me dëgjim)



Muzika dhe teksti: *M.Pecevska*




Shporta shmëngjyrëshe,
ejani të marrim
me dhurata të pashkëve
ato do t'i mbushim.

Коепички шарени,
ајде да земеме,
дарови велигденски,
во нив ќе поделиме.

*Refreni:*
Krishti u ringjall...



***Aktivitet:***

1. Gjatë festës së Pashkëve, hulumto dhe mblidh informata për traditat popullore dhe përgatit prezantim (modeli sipas dëshirës tënde).





# Shpella e mbretit të pyjeve nga suita „Per Gint” e Eduard Grig



*Edvard Grig*

Eduard Grig është kompozitor norvegjez.  Në krijimtarinë e tij shpeshherë ka përdorur këngë popullore norvegjeze dhe vallëzime të vjetra. Ai e ka shkruar muzikën për dramën ,,Per Gint”.  Përmes melodive të ndryshme (temave) përfshin ndodhi nga jeta e fshatarit të ri Per Gint.

Peri u rrit dhe jetoi në një kasolle në pyll, duke imagjinuar për aventura të ndryshme. Kur u rrit, shpeshherë ka bredhur nëpër botë ku ka përjetuar aventura të ndryshme. Që t’i paraqet këto ndodhi, kompozitori ka përdorë instrumente dhe melodi të ndryshme.



Per Ging



*shkurtabiqët ,,Trolovi”*





# Shpella e mbretit të pyjeve, pjesa e IV e suitës „Per Gint”

Peri u njoftohet me mbretin e pyjeve, i cili jeton në shpellë. Mbretërinë e tij e ruanin shkurtabiqët „trolovë”. Mbreti i pyjeve dëshironte që vajzën e tij ta martonte për Perin. Por ai nuk e donte dhe e refuzoi ofertën e mbretit. Shkurtabiqët e sulmojnë Perin dhe e zaptojnë. Në atë çast bien kambanat në kishën më të afërt. Shkurtabiqët e frikësuar ikin, ndërsa shpella rrënohet.





***Detyra:***

1. Emëroje llojin e pjesës muzikore, sipas mënyrës së performimit.
2. Përcaktoje llojin themelor të ritmit me të cilin fillon pjesa.
3. Emëroji ndryshimet e ritmit në kompozim.
4. Gjatë ridëgjimit mundohu ta ndjekësh dinamikën e performancës dhe ta emërosh ndryshimin me shprehje dinamike të përshtatshme.
5. Me çfarë ritmi dhe dinamike fillon dhe mbaron pjesa?
6. Mundohu të shpjegosh pse kompozitori e ndryshon ritmin dhe dinamikën në muzikë?



# Këndimi me dy zëra

***Të rikujtojmë:***

Tingujt në intervale i performojmë ndaras (një nga një), ose në të njëjtën kohë (së bashku). Mënyra e këtillë e performimit zbatohen dhe në këngë dhe luajtje të melodive.

Këndimi i menjëhershëm i dy melodive quhet **këndim me dy zëra.**

Në këndim dy zërash, këngëtarët ndahen në dy grupe. Grupi që e këndon melodinë e lartë është **zëri i parë**, ndërsa grupi që e këndon melodinë e ulët është **zëri i dytë**. Mënyra e këtillë e këndimit ndeshet edhe në përditshmërinë tonë.

Në këndimin me dy zëra, zëri i parë dhe zëri i dytë mund të fillojnë **njëkohësisht** (në të njëjtën kohë). *Për shembull:*

**Zëri i parë**

**Zëri i dytë**



Apo njëri pas tjetrit: *Për shembull:*

**Zëri i parë**

**Zëri i dytë**



Kur zërat fillojnë **njëri pas tjetrit dhe këndojnë të njëjtën melodi** atëherë bëhet fjalë për mënyrë të veçantë këndimi. *Për shembull:*

**Zëri i parë**

**Zëri i dytë**



Kjo mënyrë e këndimit **quhet këndim kanonik**.

**Këndimi kanonik** është lloj këndimi me shumë zëra.
Një melodi të njëjtë e këndojnë dy apo më shumë zëra,
duke filluar dhe mbaruar në kohë të ndryshme të caktuar.







# Këndimi kanonik me dy zëra



***Aktivitet:***

1. Këndojeni këngën kanoni ,,Ariu dhe mjalti”, të cilën e keni mësuar si këngë me një zë, në klasën e IV. Në shembullin e dhënë, kënga është e shkruar në dy zëra. Ndahuni në dy grupe.
2. Grupi i I - le të fillojë ta këndojë këngën;
3. Grupi i II - le të fillojë ta këndojë këngën sipas melodisë së kënduar në tekstin ,,Ariu dëshiron mjaltë të hajë”, si në shembullin e dhënë:

## *Kanoni Ariu dhe mjalti*

(me dëgjim)




Sigurisht e vërejtët se zëri i parë këngën e filloi i pari, por edhe e mbaroi i pari. ndërsa zëri i dytë filloi më vonë, në kohë të caktuar dhe gjithashtu përfundoi më vonë. Ky lloj këndi quhet këndim kanonik me dy zëra.







# Kanoni

Teksti me nota i kanonit në shumicën e rasteve regjistrohet me një zë. Vendi, në fillim të zërit të dytë shënohet me numër, si në shembullin e dhënë:

## *Këngë barinjsh*

(kanon, me nota)




Në këtë shembull, kanoni është dy zërash. Kanoni mund të jetë dhe tre zërash, katër zërash, shumë zërash.





***Aktivitet:***

1. Mësojeni këngën e njëzëshme me tekst notash.
2. Ndahuni në dy grupe dhe këndojeni këngën me tekst notash, si kanon dy zërash.

| ***Rekomandim:*** |
|---|
| Mundohuni të krijoni performancë vokale-instrumentale (njëri grup le të këndojë, tjetri grup le të luaj në instrumente). |





# „Doli Vojvoda Dellçev në atë fushë të Manastirit”

(këngë popullore)

.

Doli Goce dhe shëtiti,
në atë fushë të Manastirit.
Çfarë çudie ka parë Goce,
nëntë zinxhirë me robër.

Tre zinxhirët më përpara,
janë djem, djem të rinj,
Tre zinxhirë ata janë,
me burra pleq dhe me gra.

Tre zinxhirët më të fundit,
janë me nuse të reja.
Janë me nuse të reja,
me fëmijë meshkuj në krah.

Kur i pa pleqtë,
lotë lot prej gjaku lëshoi.
Kur i pa fëmijët,
Nga zemra Goce qau.

Излегол Гоце прошетал,
низ тоа поле битолско.
Што чудо Гоце ми видел,
девет синџира со робје.

Трите синчири најнапред,
се млади моми, момчиња.
Трите синџира они се,
со старци и со старици.

Трите синџира најназад,
саде се млади невести.
Саде се млади невести,
со машки деца на раце.

Кога ги виде старците,
крвави солзи пророни.
Кога ги виде децата,
од срце Гоце заплака.



*Vaska Ilieva*



*Goce Delçevi*

Гоце на паша говори,
мијазин море Ефенди,
робјето ослободи ги,
оти ќе платиш со глава.

Goce pashait i tha,
myezin, o efendi,
skllevërit liroji,
se me kokë do ta paguash.

Interpretuar nga: ***Vaska Ilieva***

***Detyra:***

1. Sipas ndarjes së këngëve për nga përmbajtja, në cilin grup këngësh bën pjesë „Doli Vojvoda Dellçev në atë fushë të Manastirit”?
2. Hulumtoni për këngë të tjera popullore, në të cilat është kënduar për revolucionarin maqedonas Goce Dellçev.
3. Përgatite një përmbledhje këngësh me përmbajtje patriotike.



# *Dielli*

(me nota)

Muzika: *Stefan Gajdov*
Teksti: *Dushko Avramov*

mesatar










***Aktivitet:***

1. Interpretoje këngën me nota të sakta ritmike dhe melodike, me përdorimin e elementeve të dhëna: ritmit, dinamikës dhe shenjës për ngadalësim.



***Detyrë:***

1. analizoje tekstin e këngës me nota dhe zbuloji:
   - llojin e ritmit;
   - llojin e dinamikës;
   - shenjat e shkruara të muzikës, notat dhe pushimet;
   - shenjën për vazhdimin e vlerave të notës.





# Nikollaj Rimski Korsarkov



*Nikollaj Rimski Korsarkov*

Nikollaj Rimski Korsakov (1844-1908) është kompozitor dhe pedagog i njohur rus. Dashuria për muzikën tek ai lindi nga fëmijëria e hershme. Por, për shkak të dëshirës së prindërve të tij, ai u regjistrua në shkollë detare. Në të njëjtën kohë mësoi për piano dhe teori të muzikës. Në moshën 17 vjeçare e ka njohur kompozitorin Ballakirev. Ai e vërejti talentin e Korsakovit dhe i dha përkrahje në aktivitetin e mëtejshëm të veprimtarisë muzikore.

Pas krijimit të simfonisë së parë ruse, Korsarkovi u bë pjesë e grupit të kompozitorëve më të njohur rus e quajtur si ,,Pesëshja ruse”.

Në pjesët e tij përdori motive nga folklori rus, ndërsa më tepër nga legjendat dhe tregimet popullore. I inspiruar nga legjenda ,,Sheherzadja” krijoi kompozimin, në të cilin janë paraqitur disa tregime nga ,,1001 net”. Opera ,,Përralla për mbretin Salltan”, është njëra nga veprat e tij më të njohura.

Përmbajtja e shkurtë e operës **,,Përralla për mbretin Salltan”**

Në vendin e mbretit Salltan është dëgjuar se mbreti dëshiron të martohet. Motra më e vogël nga tri motrat ka premtuar se nëse bëhet mbretëreshë do t’i lind djalë trashëgimtar, kalorës trim. Për shkak të premtimit të saj, dëshira iu plotësua. Mbreti Salltan e zgjodhi për grua. Shumë shpejt shkoi në luftë. Në ndërkohë mbretëresha lindi djalë. Motrat ziliqare i dërguan letër mbretit se gruaja e tij ka lindur përbindësh. Mbreti urdhëroi që fëmija dhe mbretëresha të futen në fuçi dhe të hidhen në det.



Të përjashtuar nga mbretëria e tyre, ata përmes valëve kanë arritur në një ishull. Pas shumë vitesh, djali i mbretit Gvidon, pas të gjitha vuajtjeve ka kërkuar që ta sheh babanë e tij, vendin e lindjes dhe fronin mbretëror. Princesha Llebed, duke e ngushëlluar Gvidonin e ka spërkatur me ujë deti dhe e ka shndërruar në brumbull. Kështu, ai ka mundur t’i vëzhgojë anijet e mbretërisë, të cilat kanë kaluar përreth ishullit Bujon, për të arritur në mbretërinë e mbretit Salltan.

Gvidoni dhe nëna e tij e presin ardhjen e mbretit Salltan, i cili pas takimit të shumë pritur, i penduar kërkoi falje për të gjitha padrejtësitë që u ka sjellë. Në dasmën e Gvidonit dhe princeshës Lebed, dhe për shkak të haresë të madhe dhe gëzimit të pa përshkuar dy motrat kërkuan falje.



# *Fluturimi i brumbullit*

Shumë i shpejtë




Kjo melodi e njohur dhe virtuoze është nxitje për shumë instrumentistë. Për këtë shkak është përshtatur për ekzekutim me instrumente të ndryshme: piano, klarinetë, flaut, saksofon dhe fizarmonikë.



## Fluturumi i brumbullit

(skenë nga opera ,,Përralla për mbretin Salltan")

Duke i shfrytëzuar mjetet shprehëse muzikore, Korsakovi bëri pasqyrim muzikor për rrugën dhe fluturimin e brumbullit në oborrin mbretëror. Takimi me mbretin Salltan dhe fluturimi rreth kokës së tij, në mënyrë impresionuese është paraqitur me ndryshimin e ritmit dhe dinamikës. Atmosfera e padurueshme, kur mbreti dëshiron ta largojë brumbullin krijon shqetësim, edhe pse në kompozim dominon hareja.



***Detyra:***

1. Emëroje llojin e ritmit në kompozim.
2. Nëpërmjet vizatimit, shprehe se çka ndjen kur e dëgjon kompozimin.





# Krijimtaria dhe shprehja muzikore

***Detyrë:***

1. Asociacion muzikor për kompozime të dëgjuara.

***Aktivitet:***

1. Arsimtari jep udhëzime për punën dhe i njofton nxënësit me mënyrën e realizimit të aktivitetit, krijimi dhe shprehja e ,,Asociacionit muzikor”.

Demonstrim me shembull:

|  |  |  |  |  |
|---|---|---|---|---|
| Insektet | Rusia | Gvidon | shpejtësi | shtet |
| Zuzulima | Sheherzadja | Opera | zog i shpej-të dinak | Moska |
| të majit | kompozitor | ishulli Bujon | vrapimi | kapela |
| **Brumbulli** | **N.R. Korsorkov** | **përralla për mbretin Salltan** | **ritëm i shpejtë** | **Rusia** |
| **FLUTURIMI I BRUMBULIT** (përgjigje përfundimtare) | | | | |

*Udhëzime për realizimin e aktivitetit:*

- Formimi i grupeve të nxënësve (nga katër deri në pesë grupe, varet nga numri i nxënësve në paralele).
- Secili grup duhet të përgatis një model asociacioni për një pjesë të dëgjuar sipas dëshirës, përgjigja nga kolonat dhe përgjigja përfundimtare nuk duhet të futen në punimin tuaj.
- Modelin e përgatitur të asociacionit duhet ta zgjidhë njëri prej grupeve të tjera.
- Prezantimi i zgjidhjes përfundimtare të modelit.

***Rekomandim:***

Ky asociacion muzikor mund të realizohet edhe në një temë tjetër, p.sh:Viti i Ri, folklori muzikor dhe krijimtaria popullore, format muzikore, etj.



# *Mollëkuqja*

Teksti: *B. Mirkullovska*
Muzika: *N.Mishçenko Vodeb*




Fluturo, fluturo mollëkuqe, më sill
mysafirë!
Shumë dua t'i shoh
krahët e tua të bukur,
të njëjtë si fustan.

Fluturo, fluturo mollëkuqe, më sill
mysafirë!
Ma plotëso një dëshirë:
Fluturo, hapi krahët,
shumë kam dëshirë që të më vijnë
gjyshi dhe gjyshja e dashur!

Лет, лет, буба Маро, донеси ми гости!
Многу сакам да ги гледам
твојте крилја лични
како фустан слични.

Лет, лет, буба Маро, донеси ми гости!
Исполни ми една желба:
Летни, шири крилја,
многу сакам да ми дојдат
дедо, баба мила!





***Detyrë:***

1. Tekstin e këngës paraqite përmes ilustrimit figurativ.







# Sonata

*(fragment)*

*V.A. Mocart*











Ktheju që nga fillimi



# Për këtë botë



Do të ndëgjosh lajm ndonjëherë,
fëmijët po vuajnë, o Zot, jo!
Në lajme dëgjoj përsëri,
në botë diku luftë e re,
dhunë e re.

Na duhet gjum i rehatshëm,
Na duhet pafajësi,
Të mos ketë frikë dhe lotë,
Çdo e keqe të largohet,
Të mos ketë ditë të zymtë për ne!

Për këtë botë, një dhe të përbashkët,
duhet të bëhemi, vetëm këtë e kemi,
Për ketë botë, që të vetme e kemi,
dhe me buzëqeshje fëmijësh duhet të luftojmë,
Pë këtë botë!

Në zemra na prek një thërrimë dashuri,
çdo çast nga një lutje.
Fëmijët janë të pafajshëm, të mësojmë nga ata,
për besimin dhe shpresën.
Neve na duhet të jetë e gjallë endrra
Që i ushqen ata për shpëtim!

Për këtë botë…
Nuk ka frikë, nuk ka uri,
të mos ketë brenga për askënd,
Për këtë botë…

Ќе чуеш глас, понекогаш,
деца страдале. О, Боже, не!
На вести слушам повторно,
во светот негде нева војна,
ново насилство.

Ни треба мирен сон,
Ни треба невиност.
Да нема страв и солзи,
Сето зло да исчезне,
Да нема тажен ден за нас!

За овој свет, еден и единствен,
треба се да сториме, само тој го имаме.
За овој свет, кој ни е единствен,
и со детска насмевка треба да се бориме,
За овој свет!

Во срцата ни допира за трошка љубов,
секој миг по една молитва.
Децата се невини, да учиме од нив
за вербата и надежта.
Нам ни треба да е жив сонот
што ги храни нив за спас!

За овој свет ..........
Нема страв, нема глад,
да нема грижи за никого.
За овој свет ...........

***Aktivitet:***

1. Përjetimet tuaja nga muzika e dëgjuar shprehi përmes vizatimit.
2. Përgatit një kartolinë me titull ,,Për të gjithë fëmijët e kësaj bote”.

***Detyrë:***

1. Përgatit album me kompozime nga këngëtarët dhe këngët tua të preferuara.



# Me muzikë në pushim

Afrohet fundi i vitit shkollor, jemi të mërzitur për shkak të ndarjes, por edhe të kënaqur për pushimin e merituar.

Këtë moment shënoje me këngë dhe valle. Bëje zgjedhjen e këngëve, të cilat do t'i dëgjosh ose do t'i këndosh. Propozimi ynë është kënga:

## *„Godina muzikore"*

Kënga është kënduar në festivalin për fëmijë
„**Bilbili i artë**", në vitin 2009.

Muzika dhe teksti: *Svetllana Pecakova*
E ekzekutoi: *Martin Joveski*



Agjelina luan në violinë,
Ema merr mësime në klavir,
E tërë ndërtesa është bërë muzikore
Jani kompozon vetë në shtrojë gjumi.

Një fqinj i yni në ashensor thotë:
Kësaj duhet t'i vendoset rregull.
Ndërsa unë, as pesë as gjashtë, me
shkop në dorë:
Nuk do të luaj kush çka të dojë.

Unë kam vendosur të jem dirigjent,
Këtu duhet të ketë një rregull,
E tërë ndërtesa dridhet, vallëzon,
Unë jam ai që komandon.

Ангелина свири виолина,
Ема часови по клавир зема,
Цела зграда ни е музикална,
Јане компонира сам во спална.

Еден сосед наш, во лифтот рече:
На ова мора да се става ред.
А јас пет-ни шест, со палка в рака:
Нема да си свирка кој што сака.

Јас сум решен да бидам диригент,
па, тука мора да има некој ред.
Цела зграда се ниша, танцува,
јас сум тој што ќе командува.

**PËRMBAJTJA:**


*Bota ime*…………. ........................................................................................4
*Këndoni fëmijë të botës*………. ...................................................................5
Vlerat e notave…………… .............................................................................6
Nota e plotë dhe pushimi………. .....................................................................7
Nota tetëshe dhe pushimi……… ......................................................................8
Aplikimi i një të tetës së notës në këngë…..........................................................9
Ushtime melodike dhe ritmike me përdorimin e notë së plotë dhe pushimit ..........10
Ushtrime melodike dhe ritmike me përdorimin e një të tetës së notës dhe pushimit ..........11
Vendi iI notave në pentagram ............................................................................12
Vendi i notave si1 dhe do2 ne pentagram .............................................................13
Bllok flaute.......................................................................................................14
Ushtrime melodike me aplikimin e notave si1 dhe do2.........................................16
Aplikimi i notave si1 dhe do2 në këngë...............................................................17
*Mësuese, ti je bota ime* ....................................................................................18
Metri................................................................................................................19
Metri binar 2/4 ..................................................................................................20
Aplikimi i metrit 2/4 në ushtrime melodike dhe ritmike dhe në këngë ....................21
*E para e dyta* ...................................................................................................22
Luajmë ne metër 2/4 ..........................................................................................23
*Vjeshta* ..........................................................................................................24
Metri trinar ¾ ...................................................................................................25
Aplikimi i metrit ¾ në ushtrime ritmike, ushtrime melodike dhe në këngë ............26
*Një, dy, tre* ......................................................................................................27
Luajmë në 3/4 të metrit .......................................................................................28
Takti katër pjesësh 4/4 ........................................................................................29
Aplikimi i metrit 4/ 4 në ushtrime melodike dhe ritmike .......................................30
*Katër nga katër* ...............................................................................................31
Katër nga katër (luajmë me instrumente fëmijësh)................................................32
Krijimet dhe shprehjet muzikore .........................................................................33
Shkalla muzikore ...............................................................................................34
Shkalla C-dur ....................................................................................................36
*Kënga e alfabetit* .............................................................................................38
Ritmi ................................................................................................................39
Metronomi ........................................................................................................40
*Ora* ................................................................................................................41
Ushtrime dhe këngë me aplikimin e ritmit të ndryshëm..........................................42
*Forma e Mekdonaldid të vjetër* ..........................................................................43
*Vëllau Martin* ..................................................................................................43
Ngadalësimi dhe shpejtimi...................................................................................44
Valsi..................................................................................................................45
Karnevali i kafshëve-Kamil Sen Sans...................................................................46
Kengurët –Kamil Sen Sans ..................................................................................47
*Viti i Ri*...........................................................................................................48
*Dordoleci*........................................................................................................49
Këmbanat bien ..................................................................................................50
Johan Shtraus ....................................................................................................52

Marshi i Radecit-Johan Shtraus ........ 53
Fraza (dytaktëshe). ........ 54
Verifikimi i tërësive muzikore, motivi dhe fraza ........ 56
*Ninullë* ........ 57
Dinamika ........ 58
Nuansat dinamike ........ 59
Mëngjesi nga suita ,,Per Gint” e Eduard Grig ........ 60
Eho-Orlando di Laso ........ 61
Shenjat për vazhdimin e vlerave të notës ........ 62
Aplikimi i shenjave për vazhdimin e vlerave të notës në ushtrim
melodike dhe këngë ........ 63
*Vashëzat e vogla* ........ 64
Johanes Brans ........ 66
Ninullë ........ 67
Intervali ........ 68
Intervali primar (i parë) ........ 69
Intervali sekondar (i dytë) ........ 70
Intervali oktavë (i tetë) ........ 71
Aplikimi i intervaleve primare, sekondare,dhe oktavës, në ushtrime melodike ........ 72
Folklori ........ 73
Elementet e folklorit ........ 74
Folklori muzikor ........ 75
Elementet e folklorit muzikor ........ 76
Këngët popullore ........ 78
*Unë të dërgova për ujë Kalinë* ........ 83
Vallja e rëndë ........ 84
Oj Suzanë ........ 86
Krijimet dhe shprehjet muzikore ........ 87
*Ditë e madhe-ditë e Pashkëve* ........ 88
Shpella e mbretit të pyjeve, nga suita ,,Per Gint” e Eduard Grig ........ 89
Shpella e mbretit të pyjeve, pjesa IV nga suita ,,Per Gint”e Eduard Grig ........ 90
Këndimi dy zërash ........ 91
Këndim kanonor dy zërash ........ 92
Kanoni ........ 93
Doli Vojvoda Dellçev në atë fushë të Manastirit ........ 94
*Dielli* ........ 95
Nikollaj Rimski Korsakov ........ 96
*Fluturimi i brumbullit* ........ 97
Krijime dhe shprehje muzikore ........ 98
*Mollëkuqja* ........ 99
Sonatë ........ 100
Për këtë botë ........ 102
Me muzikë në pushime ........ 103